



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



## **DREJTORIA E BUJQËSISË**

### **PËRKRAHJA E FERMERËVE PËR KULTIVIMIN E PEMËVE ARRORE**

### **FURNIZIMI I FERMERËVE ME FIDANE TË ARRËS**

#### **Qëllimi:**

Drejtorja e Bujqësisë në kuadër të planit zhvillimor në lëmin e bujqësisë, një rëndësi të veçantë i ka kushtuar përkrahjes së pemëtarisë, me prioritet përkrahjen e sektorit të kultivimit të pemëve arrore.

Në kuadër të kësaj përkrahje kultivimi i arrave, përkatësisht rritja e sipërfaqeve me këtë kulturë është një ndër prioritetet pasi që karakterizohet me një produktivitet të lartë e njëkohësisht edhe me një leverdi ekonomike.

#### **Përfituesit e pranueshëm:**

Përfitues i pranueshëm duhet të jetë personi fizik- fermer, të jetë banor i përhershëm i Komunës së Prishtinës, si dhe prona të jetë në territorin e Komunës së Prishtinës.

#### **Mënyra e përkrahjes së fermerëve në projekt.**

- Planifikohet furnizimi i fermerëve me fidane të arrës ;
- Do përkrahen fermerët nga 0.20 – 1.0 Ha me material fidanor të arrës;
- Furnizimi me fidane të arrës për fermerët do bëhet nga ana e Drejtorisë së Bujqësisë – Komuna e Prishtinës;
- Fermerët e kualifikuar për furnizim me fidane janë të obligura që të përcjellin të gjitha trajnimet e nevojshme për kultivimin e arrës;
- Shpërndarja e materialit fidanor do të bëhet pasi të përzgjedhen fermerët të cilët i plotësojnë kriteret e parapara;
- Përparësi do të kenë fermerët aplikues me sipërfaqe më të madhe të tokës së planifikuar për kultivimin e kësaj kulture;

#### **Kriteret e përgjithshme:**

Kriteret e përcaktuara për përkrahjen me material fidanor – arrë

- A aplikuesi duhet ta ketë pronen në territorin e Komunës së Prishtinës dhe të jetë banor i sajë;
- Sipërfaqja e planifikuar për mbjellje duhet të jetë nga 0.20-1.0 Ha;
- Përparsi do të kenë fermerët që kanë burim të ujit në parcellën e planifikuar për mbjellje;
- Para mbjelljes së materialit fidanor toka duhet të jetë e përgaditur konform kërkesave të kulturës së planifikuar për mbjellje;

**Dokumentacioni i nevojshëm:**

- Kërkesa për aplikim;
- Fotokopja e leternjoftimit;
- Certifikata mbi pronësinë e tokës jo më e vjetër se një vit;
- Kopja e planit jo më e vjetër se një vit
- Vërtetimi i tatimit në pronë;

**Data e aplikimit prej 31.10 deri më 14.11.2019**